



959

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

411

Nr. 1886/ Prot.Tiranë 5/4 /2017Lënda: Kthim përgjigje

Drejtuar: **Z. Dorian MATLIJA, Drejtor Ekzekutiv**
Qendra "Res Publica"
Bulevardi "Gjergj Fishta", Nd.24, H.3, Ap.44

Tiranë**I nderuar z.Matlija,**

Në përgjigje të shkresës suaj nr. prot 1896 hyrës, datë 03.04.2017, me anë të të cilës kërkohet vënia në dispozicion të një kopje të listës të 18 veprave në pikturë dhe vizatim, pjesë e fondit të Galerisë Kombëtare të Arteve, që do të dërgohen jashtë Shqipërisë, me qëllim realizimin e ekspozitave "Documenta 14" të miratuar me vendim nga Këshilli i Ministrave më datë 29.03.2017(<http://www.kryeministria.al/al/newsroom/vkm/vendime-te-miratuara-ne-mbledhjen-e-keshillit-te-ministrave-date-29-mars-2017&page=1>), bashkëlidhur do të gjeni kopje të :

-Vendimit nr.271, datë 29.03.2017 të Këshillit të Ministrave "Për lëvizjen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të 18 veprave të artit në pikturë dhe vizatim, pjesë e fondit të Galerisë Kombëtare të Arteve, me qëllim realizimin e ekspozitave "Documenta 14", që do të zhvillohen në ambientet e Muzeut Kombëtar të Artit Bashkëkohor Athinë, Greqi dhe në Muzeun e Arteve të Bukura, Neue Galerie, Kassel, Gjermani",

-Listës së veprave të ekspozitës "Dokumenta 14" në Athinë,

-Listës së veprave të ekspozitës "Dokumenta 14" në Kassel.

Duke ju falenderuar,





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 271, datë 29.3.2017

PËR

**LËVIZJEN JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
TË 18 VEPRAVE TË ARTIT NË PIKTURË DHE VIZATIM, PJSË
E FONDIT TË GALERISË KOMBËTARE TË ARTEVE, ME QËLLIM
REALIZIMIN E EKSPOZITAVE "DOCUMENTA14",
QË DO TË ZHVILLOHEN NË AMBIENTET E MUZEUT KOMBËTAR
TË ARTIT BASHKËKOHOR ATHINË, GREQI, DHE NË MUZEUN
E ARTEVE TË BUKURA, NEUE GALERIE, KASSEL, GJERMANI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 19, të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003, "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Lejimin e lëvizjes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të 15 (pesëmbëdhjetë) veprave të artit në pikturë dhe vizatim, pjesë e fondit të Galerisë Kombëtare të Arteve, me qëllim realizimin e ekspozitës që do të zhvillohet në ambientet e Muzeut Kombëtar të Artit Bashkëkohor, Athinë, Greqi, sipas tabelës I, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Lejimin e lëvizjes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të 3 (tre) veprave të artit në pikturë dhe vizatim, pjesë e fondit të Galerisë Kombëtare të Arteve, me qëllim realizimin e ekspozitës që do të zhvillohet në ambientet e Muzeut të Arteve të Bukura, *Neue Galerie*, Kassel Gjermani, sipas tabelës II, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Lejimi i lëvizjes të bëhet nga data 31 mars 2017 deri më 6 gusht 2017, për veprat e artit, pjesë e fondit të Galerisë Kombëtare të Artit, që kërkohen të ekspozohen në Muzeun e Artit Bashkëkohor Athinë, Greqi.

4. Lejimi i lëvizjes të bëhet nga data 2 maj 2017 deri më 8 tetor 2017, për veprat e artit, pjesë e fondit të Galerisë Kombëtare të Artit, që kërkohen të ekspozohen në Muzeun e Arteve të Bukura, *Neue Galerie*, Kassel, Gjermani.
5. Ekspozimi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të bëhet në përputhje me udhëzimin nr.2, datë 18.3.2004, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e lëvizjes së objekteve të trashëgimisë kulturore, të luajtshme, me vlera të veçanta kombëtare dhe unike, për ruajtjen, restaurimin, studimin dhe ekspozimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë".
6. Ngarkohet Galeria Kombëtare e Arteve të kryejë shoqërimin dhe kthimin e veprave në vendin e origjinës, pas mbarimit të veprimtarisë, dhe Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore të kryejë regjistrimin e lëvizjes së objekteve.
7. Ngarkohet ministri i Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

NIKO PELESHI

MINISTRI I KULTURËS
MIRELA KUMBARO BURXHI

TABELA I

Lista e veprave të ekspozitës "Dokumenta 14" në Athinë

Nr.	Nriv.	Emri i autorit	Titulli i veprës	Përmasat	Teknika	Materialet	Viti	Çmimi në ALL
1	50	Kel Kodheli	Enrushi (Arabi)	70 x 56 cm	Vaj	Kompozitë	1944 - 1945	350.000
2	165	Androniqi Antoniu	Autoportret	32 x 43,5 cm	Vaj	Bore	1935	150.000
3	461	Abdurrahim Buza	Refugjatët	50 x 41 cm	Vaj	Kanavacë	1957	500.000
4	485	Abdurrahim Buza	Autoportret	41,5 x 30,5 cm	Vaj	Kompozitë	1934	500.000
5	748	Hasan Nalboni	Me shatë në krah	90 x 70 cm	Vaj	Kanavacë	1966	150.000
6	765	Spiro Kristo	Ferrijet	195 x 200,5 cm	Vaj	Kanavacë	1966	150.000
7	902	Safir Çapo	Produksija e telave elektrike	120 x 93 cm	Vaj	Kanavacë	1969	150.000
8	905	Zef Shoshi	Tornitoja	120 x 85 cm	Vaj	Kanavacë	1969	250.000
9	1166	Llambri Bllido	Në pulin e komandimit	118 x 129 cm	Vaj	Kanavacë	1971	150.000
10	1231	Arben Basba	Ënë do të shkruaj	102 x 139,5 cm	Vaj	Kanavacë	1971	150.000
11	1828	Spiro Kristo	Brigadierja	110 x 130 cm	Vaj	Kanavacë	1976	100.000
12	1924	Handi Mele	Ushtrare të revolucionit	124 x 100 cm	Vaj	Kanavacë	1968	150.000

13	2058	Gani Strazimiri	Pazari i vjetër i Tiranës	64 x 99 cm	Vaj	Kompozitë	1936	200.000
14	3538	Foto Stano	Refuziatët (2)	31 x 47 cm	Vaj	Kompozitë	1941	200.000
15	1307	Edi Hila	Mbjellja e pemëve	150 x 199 cm	Vaj	Kanavaçë	1971	350.000

TABELA II

Lista e veprave të ekspozitës "documenta 14" në Kassel

Nr.	Nc.inv.	Emri i autorit	Titulli i veprës	Përmasat	Teknika	Materiali	Viti	Çmimi në lekë
1	2759	Androniqi Antoniu	Në kopshtin e Renujëve	32 x 24 cm	Laps	Leter	1948	50.000
2	2761	Androniqi Antoniu	Në pazarin e Krujës	28 x 33 cm	Laps	Leter	1938	100.000
3	3585	Hasan Reçi	Çikël për 4 shkurtin (6)	26 x 19 cm	Laps	Leter	-	80.000

NR.PROT.1838/1
DATE: 30.3 2017

MINISTRISË SË KULTURËS
GALERISË KOMBËTARE TË ARTEVE
QENDRËS KOMBËTARE TË INVENTARIZIMIT
TË PASURIVE KULTURORE
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

